



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 975/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 02.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 01.12.2013 në ora 18:05 nga parashtruesi i ankesës PDK ku ka pretenduar se, me dt. 01.12.2013 në ora 10:21 në fshatin Musakë, në shkollën fillore “Mejdi Xhaferi” e njëjta Qendër e Votimit QV 2529D janë keqpërdorur veturat zyrtare të KEDS-it nga militantët e koalicionit LDK-AAK, ku Izet Rushiti me qëllim të përfitimit të votave për LDK-në ka keqpërdorur veturat zyrtare të KEDS-it. Më tutje ka shtuar se, punëtorët e KEK-ut të uniformuar janë vërejtur duke bartur dhe sjellë persona në QV .

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimet e bëra janë në kundërshtim me Rregullat Zgjedhore nr.11/2013, neni 6 i Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, neni 35 të LZP-së. Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi 3 fotografi si provë .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga PDK- ja pretendohet se janë keqpërdorur veturat zyrtare të KEDS-it nga militantët e koalicionit LDK-AAK, ku Izet Rushiti me qëllim të përfitimit të votave për LDK-në ka keqpërdorur veturat zyrtare të KEDS-it, mirëpo nga pretendimet e cekura nuk mund të vërtetohet se është kryer një veprim i ndaluar.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet e tilla ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar, pasi që veturat e lartcekura nuk janë pronë publike por janë

pronë e KEDS-it, për më tepër dëshmitë e ofruara nuk janë te asaj natyre që do të mund të vërtetohen se janë bartur persona me veturat e KEDS-it, prandaj pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 975/2013 më datën 02.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.